



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BULQIZE
DREJTORIA E SHERBIMEVE, EMERGJENCAVE CIVILE DHE RRUGET RURALE

RELACION TEKNIK

**OBJEKTI: Riparim shtresa rrugore dhe vepra arti ne rruget rurale + Rehabilitim Pasarela
Zall- Sopot , sinjalistika.**

VITI I NDERTIMIT 2018

Nisur nga nevojat per nderhyrje ne rruget rurale dhe bazuar ne buxhetin e planifikuar per kete qellim eshte llogaritur te nderhyhet ne objektet e meposhteme:

A. Nj.A. Martanesh

- I.** Rrruga Kraste- Ballenje. Ky objekt ka nje gjatesi nga Krasta- Qafat e Himes prej 29 km. Shtresat rrugore jane me cakull dhe ka nje gjeresi 3.5 m. Ne kete rruge eshte menduar te nderhyhet me riparimin e shtresave te cakullit ne kilometrin e fundit pjese fundore ku shtresat nuk ekzistojne fare te demtuara nga erozioni. Eshte rruge e qarkullushme per zezionin e veres.
- II.** Rruga Kraste – Peshk Ka nje gjatesi 7.5 km dhe gjeresi te trupit te rruges 3.5 – 4 ml. Si rezultat i reshjeve te pranveres ka demtime serioxe ne shtresat rrugore dhe prishje te kanalit anesor. Eshte planifikuar nderhyrje ne riparimin e shtresave ne kilometrin 4-5 te rruges si dhe hapja e kanalit anesor.

B. Nj.A. Fushe Bulqize

- I.** Rruga Dushaj (Kodra e Danit- Dushaj) me gjatesi 2.7 km dhe gjeresi te trupit te rruges 3m. Ne kete objekt eshte planifikuar ndertimi i murit mbajtes ne hyrje te rrukes kilometri 01. Muri ka nje gjatesi 18 ml dhe lartesi mesatare 2,5 m. Do te realizohet me gure kave dhe llac cemento M50 dhe brez betoni t= 15 cm. Gjithashtu riparimi i shtresave rrugore ne kilometrin 1 te saj.
- II.** Rruga “Kokerdhak (Kryq tre fshatra- Kokerdhak) ka nje gjatesi 1.7 km dhe gjeresi te trupit te rruges 3.5 m. Eshte planifikuar per nderhyrje ne ndertimin e dy tombinave me L= 6 ml ku do te realizohet me tubo betoni 600 mm si dhe riparimi i shtresave rrugore. Keto punime jane planifikuar ne kilometrin e fundit te rruges.

C. Nj.A. Ostren

- I.** Rrruga Ostren i Vogel (Kryqezim Trebisht- Ostren i vogel) Rruga ka nje gjatesi 2 km dhe 3 m gjeresia e trupit te rruges.
Ne mbarimin e kilometrit te pare eshte planifikuar ndertim muri mbajtes me gjatesi 40 ml dhe lartesi 1.5 m mesatare me gure kave dhe llac cemento M50 si dhe riparimi shtresave rrugore 300 m2.

D. Nj.A. Gjorice

I. Rruga Cerenc i Siperm Njesia Administrative Gjorice. Kjo rrugë lidh Cerencin e siperm me rrugën kryesore që shkon në Golloborde. Ka një gjatësi 1 km dhe gjeresi 3 m. Si rezultat i rreshqitjes së tokës është planifikuar ndërtim muri beton/arme të Markes C-16/20 i armuar me hekur betoni 12 mm si dhe riparimi i pjesshëm i shtresave të cakullit prej 300 m². Muri ka një gjatësi 20 m dhe lartësi 2 m.

II. Rruga “Cifligu” Gjorice me gjatësi 1.7 km dhe gjeresi 3-3.5 m. Në këtë objekt është planifikuar ndërtim muri mbajtes me gjatësi 15 m dhe lartësi 2.5 m. Muri do realizohet me gurë lumi dhe llacimento M50 si dhe brez betoni t = 15 cm.

E. Nj.A. Zerqan

I. Rruga Strikcan. Ka një gjatësi 4 km dhe trupi i rrugës 3-3.5 m. Kjo rrugë lidh qendrën e fshatit Strikcan me rrugën kryesore tek H/C. Për funksionimin normal të kësaj rrugë si dhe jetëgjatësi të saj është planifikuar ndërtimi i murit mbajtes në pjesën perendimore në qendër të fshatit. Muri ka gjatësi 40 m dhe lartësi 2 m. Do të realizohet me gurë kave dhe llacimento të Markes 50 si dhe brez betoni t = 15 cm. Gjithashtu si rezultat i kalimit të kanalit vadites në rrugë janë planifikuar vendosje tubo celiku 219 mm gjithsej 18 m ku janë tre kalime të kanalit vadites.

II. Rruga Zall- Strikcan ka një gjatësi 3.2 km dhe gjeresi 3.5 m. Është planifikuar ndërtim mure mbajtes në qendrën e fshatit lagja “Mete” me gjatësi 15 m dhe lartësi 2 m. Muri është planifikuar të ndërtohet me gurë kave dhe llacimento M50. Gjithashtu është planifikuar ndërtimi i shtresave të cekullit dhe të stabilizantit pjesërisht në vendet e demtuara me sipërfaqe 600 m².

F. Sinjalistika rrugore

Janë planifikuar vendosje e tabeleave treguese për qendrat e banuara (fshatrat) gjithsej 15 cope të shpërndara këtu në të gjitha Njesitë. Tabela të ndryshme 10 cope ku pasqyrojnë “pikë rreziku. Ndallim kalimi, ngushtice rrugë, kthesa etj.

G. Rehabilitimi i pasareles Zall- Sopot.

Kjo pasarele shërben për kembësorë që shërben Zall- Sopotit, Sopotit etj për të lidhur me rrugën kryesore Krajke. Për funksionimin e kësaj pasarele është planifikuar ndërtimi i bazamentit në pjesën jugore e cila ekzistuesja është demtuar nga lumi dhe është jashtë funksionit. Për këtë qëllim është planifikuar ndërtim i ri si dhe tubo celiku për fiksimin e kavove. Terheqje e tendosje të kavove me traktor si dhe ndërtimi i dyshemese me derrase pishë të stazhionuar 5 cm.

H. Rruga fshati Topojan Njesia Administrative Shupenze.

Ka një gjatësi 3000 m. Do të ndërtohet shtresa e parë t = 10 cm me cakull i shtrirë dhe ngjeshur me makineri në gjatësinë prej 2 km dhe trupi i rrugës 3 m me sipërfaqe 6000 m². Do të bëhet hapja e kanalit anësor me eskavator në të gjithë gjatësinë e rrugës me seksion 0.16 m³/m.

Pregatiti
Mevlut Karaj